

Dt.11.12.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje Shërbim të Printimit”**.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Printime dhe shërbime të lidhura 79800000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: **29,162,200**(njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh, me objekt: **“Blerje Shërbim të Printimit”**, vënë në dispozicion me anë të V.K.B-së Nr. 125 dt 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, i ndryshuar.

**Kohëzgjatja në muaj: 36** (tridhjetë e gjashtë) muaj/ 3 (tre) vjet **(nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër**

*Afati i implementimit të infrastrukturës së nevojshme në funksion të ofrimit të shërbimit do të jetë jo më shumë se 2 (dy) muaj nisur nga data e lidhjes së kontratës.*

**Lloji i Marrëveshjes Kuadër do të jetë me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër**

*AK arsyeton se: Qëllimi është vendosja e kushteve të njëjta për lidhjen e kontratave, gjatë periudhës kohore të marrëveshjes kuadër. Për arsye teknike dhe organizative, realizimi nga operatorë ekonomikë të ndryshëm nuk është i favorshëm, duke i shkakuar vështirësi autoritetit kontraktor dhe kosto shtesë (të tilla si, mospërputhje e teknologjive të pajisjeve teknike të kërkuara për realizimin e këtij shërbimi nëpërmjet një komponenti software (menaxhim, konfigurim dhe monitorim i pajisjeve në mënyrë të centralizuar, referuar kërkesave teknike), kjo mospërputhje do vështirësonte menaxhimin, përdorimin, funksionimin, eficientësinë e të gjithë sistemit në tërësinë e tij dhe realizimin e kontratës nëse do të ofrohej nga operatorë ekonomikë të ndryshëm).*

**Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:**

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar zërave të preventivit, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë, pasi do e bënte shumë të vështirë për t’u menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues pas procesit të minikonkursit, pasi dhenia e shërbimit të printimit nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizimin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit të printimit për të garantuar vazhdueshmërinë e

shërbimeve të administratës për përdoruesit, si dhe kosto shtesë për AK.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e artikujve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin në kohë, për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve të administratës për përdoruesit, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale”.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriteve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së (I ndryshuar), ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me

kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar, për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në këto kushte, duke qenë se kemi të bëjmë me një familje shërbimesh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Në varësi të zërave që do të marrin përsipër të mbulojnë apo bashkimin e fuqisë punëtore dhe stafit, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së (i ndryshuar), dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njih të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik(i ndryshuar): citojmë Neni 83 i LPP(I ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP(i ndryshuar), nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

### **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: **29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind)** lekë pa tvsh. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 3.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore*

*brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

*\*\*\* Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP(i ndryshuar), nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë*

23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) **ISO 9001:2015** - për “Sistemin menaxhimin e cilësisë”
- b) **ISO 20000** për “Sistemin e menaxhimit të shërbimit”
- c) **ISO 27001** për “Sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit”

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar),

*“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie...”*

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

**Kërkesa për Standardin 9001:2015 ose ekuivalente**

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga ofruesi i shërbimit, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin e shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Për sa më sipër, kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar me sukses kontratën.

***Kërkesa për Standardin ISO 20000 (ose ekuivalente) - për “Sistemin e menaxhimit të shërbimit”***

ISO 20000 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon Autoriteti Kontraktor nga operatorët ekonomike për: organizim, planifikim e ndjekje konsistente të shërbimeve deri në kryerjen e plotë të tyre sipas kërkesave të DST-së.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

*Për sa më sipër, kërkesa për ISO 20000 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.*

***Kërkesa për Standardin ISO 27001(ose ekuivalente) për “Sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit”***

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me:

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara në projekt, si:

...“

- *Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë...*
- *Për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkohen të lëvrohen, instalohen dhe konfigurohen në ambientet dhe infrastrukturën e institucionit komponentët:*

- *Pajisje printimi, fotokopjimi dhe skanimi*
- *Komponenti Software (menaxhim dhe monitorim)*
- *Print Server*

...”

Për sa më sipër, nëpërmjet kësaj kontrate kërkohen shërbime mirëmbajtje dhe shërbime që do të kryhen në ambiente sensitive të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë si Dhoma e Serverave dhe ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese për konfigurimet e kërkuara dhe si rrjedhojë kërkesa për ISO 27001, garanton se Operatori Ekonomik përdor dhe aplikon praktikat më të mira të sigurisë për shërbime të kryera në ambiente sensitive dhe jo vetëm.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt të kësaj kontrate, duhet të disponojë stafin e inxhinierëve të profileve si më poshtë:

- ✓ 1 (një) Inxhinier Informatikë
- ✓ 1 (një) Inxhinier Elektrik
- ✓ 1 (një) Inxhinier Elektronik
- ✓ 1 (një) Inxhinier Fizikë
- ✓ 1 (një) Inxhinier Teknologji informacioni, ose mekatronik

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e inxhinierëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratë pune e vlefshme ,kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

*Kriteri 2.3.3 dhe nënpikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*



*Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.*

Numri i përcaktuar për secilin nga teknikat është përllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

*Referuar termave të referencës, preventivit, natyrës dhe objektit të saj, si dhe shërbimeve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, shfaqet e nevojshme zotërimi i stafit me kompetencat e mësipërme.*

**Argumentin teknik për personelin teknik si mëposhtë:**

- 1 (një) Inxhinier Informatikë
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) Inxhinier Fizikë
- 1 (një) Inxhinier Teknologji informacioni, ose mekatroni

Fushat e përmendura të diplomimit sipas kërkesave të kriterit 2.3.3 janë pjesë e fushave të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, sikurse është dhe i fokusuar tërësisht projekti objekt prokurimi. Përgjithësisht, kjo kërkesë për personel të diplomuar në fusha teknologjike ka për qëllim sigurimin e një ekipi me njohuri dhe aftësi të specializuara për të siguruar suksesin e implementimit të shërbimit referuar instalimeve të pajisjeve, komponentit sofëtare dhe print server si dhe cdo shërbim që do të ofrohet përgjatë periudhës të gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet realizimi i kontratës brenda afateve kohore të specifikuar në dokumentin e termave të referencës së kësaj procedure, ku është e domosdoshme të parashikohen dhe rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (trajtime, leje vjetore, raport mjekësor, etj).

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për implementimin dhe për suportin përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me çertifikata të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve të ofertuara apo nga distributori i autorizuar për pajisjet e ofertuara me kusht që të provohet e drejta legjitime e distributorit për të trajnuar dhe çertifikuar stafin, për të vërtetuar aftësinë e tyre për implementim, konfigurime të komponentit softëare të kërkuar, përmbushjen e termave të SLA si dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar si project Manager ose ekuivalent për të siguruar implementimin e suksesshem të shërbimit të kërkuar përgjatë kohezgjatjes së kontratës.

- b. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- c. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- d. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- e. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- f. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- g. Të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar për komponentin software të ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- h. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Switching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes software dhe të pajisjeve të kërkuara.
- i. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit software në infrastrukturën përkatëse dhe AD.
- j. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave.

Kriteri 2.3.4 dhe nënplikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që priten të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin nga teknikat është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

**Argumentin teknik për personelin teknik si mëposhtë:**

**Argumenti:** Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar si Menaxher Projekti për të siguruar implementimin e suksesshem të shërbimit të kërkuar përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Për mirë-menaxhimin e kontratës dhe sigurinë që të përmbushen detyrimet kontraktuale, është e domosdoshme prezenca e një menaxheri projektsh të certifikuar.

Kjo kërkesë garanton që Operatori Ekonomik do të angazhojë specialistë të certifikuar për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të shërbimit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës së kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit.

Si rrjedhojë një punonjës i certifikuar si menaxher projekti siguron që kontrata të jetë e suksesshme duke koordinuar dhe menaxhuar të gjitha aspektet në përmbushje të qëllimit të kontratës dhe menaxhim të sinkronizuar. Menaxheri i projektit duhet të njihet me ToRS të kësaj procedure prokurimi, të cilin do e menaxhojë sipas kërkesave të Autoritetit, do realizojë monitorimin dhe raportimin përgjatë shtrirjes së kontratës dhe do të garantojë zbatimin dhe realizimin me sukses të projektit në kohë me cilësi dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

**Argumenti:** Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe, është një kërkesë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe me dokumentin e Termat e Referencës dhe Specifikimeve Teknike.

Qëllimi i kërkesës për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe është që Autoriteti Kontraktor të garantojë që operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrat specifike të kërkuara konkretisht për këtë zë “Pajisje A3 Bardh e zi e madhe”, objekt kontrate.

Më konkretisht në dokumentin e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike është kërkuar:

...“Për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkohen të lëvrohen, instalohen dhe konfigurohen në ambientet dhe infrastrukturën e institucionit komponentët:

- *Pajisje printimi, fotokopjimi dhe skanimi....*

**Më poshtë, analiza e situatës së prishme/ të parashikuar, të numrit pajisjeve që do të lëvrohen:**

***1. Pajisje A3 Bardh e zi e madhe sasia - 80 copë....”***

- *Furnizimi (vënia në dispozicion) me pajisje të reja sipas kërkesave në këtë dokument; instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimi (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë, zëvendësimi e pjesëve konsumuese vetëm origjinale (toner/bojëra origjinal, drum origjinal, rula të ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.*

Referuar sa më sipër, një specialist i certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe garanton AK, se

Operatori Ekonomik disponon staf të kualifikuar për realizimin e instalimit, konfigurimeve si dhe shërbimeve të mirëmbajtjes përgjatë të gjithë periudhës së kontratës për këtë model pajisje. Gjithashtu duke marrë në konsideratë sasinë e konsiderueshme të pajisjeve që kërkohen (80 copë) si dhe vendndodhjet e ndryshme në të cilën do instalohen pajisjet, është e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë të paktën 2 (dy) specialist për të mbuluar shërbimet e kërkuara në vendndodhjet e ndryshme si dhe sasinë e kërkuar.

**Argumenti:** Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël, është një kërkesë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe me dokumentin e Termat e Referencës dhe Specifikimeve Teknike.

Qëllimi i kërkesës për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël është që Autoriteti Kontraktor të garantohet që operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrat specifike të kërkuara konkretisht për këtë zë “Pajisje A3 Bardh e zi e vogël”, objekt kontrate.

Më konkretisht në dokumentin e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike është kërkuar:

...“Për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkohen të lëvrohen, instalohen dhe konfigurohen në ambientet dhe infrastrukturën e institucionit komponentët:

- *Pajisje printimi, fotokopjimi dhe skanimi...*

**Më poshtë, analiza e situatës së prishme/ të parashikuar, të numrit pajisjeve që do të lëvrohen:**

***Pajisje A3 Bardh e zi e Vogël sasia - 30 copë...***

- *Furnizimi (vënia në dispozicion) me pajisje të reja sipas kërkesave në këtë dokument; instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimi (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë, zëvendësimi e pjesëve konsumuese vetëm origjinale (toner/bojëra origjinal, drum origjinal, rula të ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.*

Referuar sa më sipër, një specialist i certifikuar për Pajisje A3 Bardh e vogël garanton AK, se Operatori Ekonomik disponon staf të kualifikuar për realizimin e instalimit, konfigurimeve si dhe shërbimeve të mirëmbajtjes përgjatë të gjithë periudhës së kontratës për këtë model pajisje. Gjithashtu duke marrë në konsideratë sasinë e pajisjeve që kërkohen (30 copë) si dhe vendndodhjet e ndryshme në të cilën do instalohen pajisjet, është e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë të paktën 2 (dy) specialist për të mbuluar shërbimet e kërkuara në vendndodhjet e ndryshme si dhe sasinë e kërkuar.

**Argumenti:** Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra, është një kërkesë e lidhur

ngushtë me objektin e prokurimit dhe me dokumentin e Termat e Referencës dhe Specifikimeve Teknike.

Qëllimi i kërkesës për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra është që Autoriteti Kontraktor të garantohet që operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrat specifike të kërkuara konkretisht për këtë zë “Pajisje A3 Me Ngjyra”, objekt kontrate.

Më konkretisht në dokumentin e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike është kërkuar:

...“Për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkohen të lëvrohen, instalohen dhe konfigurohen në ambjentet dhe infrastrukturën e institucionit komponentët:

- *Pajisje printimi, fotokopjimi dhe skanimi....*

**Më poshtë, analiza e situatës së pritshme/të parashikuar, të numrit pajisjeve që do të lëvrohen:**

***Pajisje A3 Me Ngjyra sasia - 15 copë...”***

- *Furnizimi (vënia në dispozicion) me pajisje të reja sipas kërkesave në këtë dokument; instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimi (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë, zëvendësimi e pjesëve konsumuese vetëm origjinale (toner/bojëra origjinal, drum origjinal, rula të ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.*

Referuar sa më sipër, një specialist i certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra garanton AK, se Operatori Ekonomik disponon staf të kualifikuar për realizimin e instalimit, konfigurimeve si dhe shërbimeve të mirëmbajtjes përgjatë të gjithë periudhës së kontratës për këtë model pajisje. Gjithashtu duke marrë në konsideratë sasinë e pajisjeve që kërkohen (15 copë) si dhe vendndodhjet e ndryshme në të cilën do instalohen pajisjet, është e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë të paktën 2 (dy) specialist për të mbuluar shërbimet e kërkuara në vendndodhjet e ndryshme si dhe sasinë e kërkuar.

**Argumenti:**Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

Kërkesa për të paktën 1 (një) specialistë të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar, është një kërkesë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe me dokumentin e Termat e Referencës dhe Specifikimeve Teknike.

Qëllimi i kërkesës për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar është që Autoriteti Kontraktor të garantohet që operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrat specifike të kërkuara konkretisht për këtë zë “Pajisje A4 Printer”, objekt kontrate.

Më konkretisht në dokumentin e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike është kërkuar:

...“Për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkohen të lëvrohen, instalohen dhe konfigurohen në ambjentet dhe infrastrukturën e institucionit komponentët:

- *Pajisje printimi, fotokopjimi dhe skanimi....*

**Më poshtë, analiza e situatës së pritshme/të parashikuar, të numrit pajisjeve që do të lëvrohen:**

### ***Pajisje A4 Printer sasia - 70 copë...***

- *Furnizimi (vënia në dispozicion) me pajisje të reja sipas kërkesave në këtë dokument; instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimi (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë, zëvendësimi e pjesëve konsumuese vetëm origjinale (toner/bojëra origjinal, drum origjinal, rula të ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.*

Referuar sa më sipër, një specialist i certifikuar për Pajisje A4 Printer garanton AK, se Operatori Ekonomik disponon staf të kualifikuar për realizimin e instalimit, konfigurimeve si dhe shërbimeve të mirëmbajtjes përgjatë të gjithë periudhës së kontratës për këtë model pajisje.

**Argumenti:** Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar, është një kërkesë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe me dokumentin e Termat e Referencës dhe Specifikimeve Teknike.

Qëllimi i kërkesës për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar është që Autoriteti Kontraktor të garantohet që operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrat specifike të kërkuara konkretisht për këtë zë “Pajisje Printer Barcode”, objekt kontrate.

Më konkretisht në dokumentin e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike është kërkuar:

...“Për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkohen të lëvrohen, instalohen dhe konfigurohen në ambjentet dhe infrastrukturën e institucionit komponentët:

- *Pajisje printimi, fotokopjimi dhe skanimi...*

**Më poshtë, analiza e situatës së pritshme/të parashikuar, të numrit pajisjeve që do të lëvrohen:**

### ***Pajisje Printer Barcode sasia - 1 copë...***

- *Furnizimi (vënia në dispozicion) me pajisje të reja sipas kërkesave në këtë dokument; instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimi (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë, zëvendësimi e pjesëve konsumuese vetëm origjinale (toner/bojëra origjinal, drum origjinal, rula të ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.*

Referuar sa më sipër, një specialist i certifikuar për Pajisje Printer Barcode garanton AK, se Operatori Ekonomik disponon staf të kualifikuar për realizimin e instalimit, konfigurimeve si dhe shërbimeve të mirëmbajtjes përgjatë të gjithë periudhës së kontratës për këtë model pajisje.

**Argumenti:** Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për komponentin software të ofertuar për te implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për komponentin software të ofertuar”, lidhet me domosdoshmërinë për prezencën në stafin e OE të paktën 2 (dy) specialist të certifikuar të cilët përmbushin standardet minimale dhe profesionale për të realizuar instalimin dhe konfigurimin me sukses të platformës, si dhe për të suportuar në rast problemesh përgjatë të gjithë afatit të kontratës.

Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për komponentin software të ofertuar, gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me realizimin e instalimit, konfigurimit dhe integritetit të platformës duke përmbushur të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat nga autoritetit kontraktor, konkretisht për zërin:

- ***Komponenti Software (menaxhim dhe monitorim)***

**Argumenti:** Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Switching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes software dhe të pajisjeve të kërkuara.

Një specialist i certifikuar në nivel nivel Associate për Routing dhe Switching ose ekuivalent, shërben si garanci për realizimin e instalimeve dhe konfigurimeve në infrastrukturën ekzistuese në institucion të pajisjeve, objekt kontrate, dhe për realizimin me sukses dhe në kohë të kontratës në tërësi.

Sa më sipër cituar, kërkesa e autoritetit kontraktor, është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me natyrën dhe objektin e prokurimit.

**Argumenti:** Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit software në infrastrukturën përkatëse dhe AD.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për “Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit software në infrastrukturën përkatëse dhe AD, është e bazuar dhe e lidhur me zërin ***Komponenti Software (menaxhim dhe monitorim)***, objekt kontrate.

Nëpërmjet kësaj kontrate kërkohet të realizohet “*Sigurimi i një server për të qendëruar përpunimin dhe ruajtjen e dokumentave dhe software të centralizuar për menaxhimin dhe monitorimin e shërbimit. Realizimi i instalimit dhe konfigurimit të tyre në infrastrukturën ekzistuese në institucion.*”, bazuar në termat e references dhe specifikimet teknike.

Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit software në infrastrukturën përkatëse dhe AD, shërben si garanci për realizimin e instalimeve dhe konfigurimeve në infrastrukturën ekzistuese në institucion dhe AD, të sistemit software objekt kontrate.

**Argumenti:** Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për “Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar ne nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme ne infrastrukturën e serverave, është e bazuar dhe e lidhur me zërin **Print Server**, objekt kontrate.

Nëpërmjet kësaj kontrate kërkohet të realizohet “**Sigurimi i një server për të qendëruar përpunimin dhe ruajtjen e dokumentave dhe software të centralizuar për menaxhimin dhe monitorimin e shërbimit. Realizimi i instalimit dhe konfigurimit të tyre në infrastrukturën ekzistuese në institucion.**”, bazuar në termat e references dhe specifikimet teknike.

Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar ne nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme ne infrastrukturën e serverave, shërben si garanci për realizimin e instalimeve dhe konfigurimeve në infrastrukturën ekzistuese në institucion të serverit objekt kontrate.

Sa më sipër cituar, kërkesa e autoritetit kontraktor, është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me natyrën dhe objektin e prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për rajonin e Shqipërisë për te gjitha pajisjet dhe komponentin software të ofertuara, për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

#### **Argumentimi:**

Referuar nenit 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”*

Duke qenë se Autoriteti kontraktor, është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për të gjitha pajisjet dhe komponentin software të ofertuara, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi/ distributori i autorizuar për zërat e kërkuar sipas kriterit, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.



2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 6 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhene shërbimin në kohë në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë. Për vërtetimin e disponueshmërisë së mjeteve OE duhet të paraqesë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatë pronësie, plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit objekt i këtij prokurimi. Për mjetet që nuk regjistrohen në regjistrat publik duhet të paraqiten kontrata shitblerje/fatura tatimore/dokumentat e zhdoganimit të paisjeve.

Kriteri 2.3.6 dhe nën pikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumenti:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 41 pika 4, i cili përcakton se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

***ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.***

*d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

Pjesë e kësaj kontrate është parashikuar të realizohet furnizimi dhe mirëmbajtja e një sasive të konsiderueshme prej 228 pajisjeve dhe për me tepër e shpërndarë në 47 vendndodhje të ndryshme të shpërndara gjeografikisht në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë (përcaktuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike).

Duke mbajtur në konsideratë afatin e ngushtë të ekzekutimit të kontratës, konkretisht dy muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe përgjatë kësaj periudhe përfshihet jo vetëm lëvrimi i një sasive voluminoze pajisjesh në të gjithë vendndodhjet e përcaktuara për ofrimin e shërbimit (47 vendndodhje të ndryshme), por edhe instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit, në mënyrë që shërbimi të jetë aktiv brenda afatit dy mujor të parashikuar, është e nevojshme dhe e domosdoshme kërkesa që OE të disponojë minimalisht 6 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhënë shërbimin në kohë në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.

### **Argumentimi:**

Bazuar në nenin 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c)

aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

AK, në një projekt ku është parashikuar të realizohet një shërbim i domosdoshëm dhe i vijueshëm për çdo ditë punë, ku kërkohet vendosja në dispozicion e 228 pajisjeve dhe për me tepër e shpërndarë në 47 vendndodhje të ndryshme të shpërndara gjeografikisht në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë (përcaktuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike), e vlerëson të nevojshëm dhe bazike kërkesën për të patur stok 45 % të pajisjeve.

AK ka përcaktuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, afatin e ekzekutimit, konkretisht dy muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Gjatë këtij afati, përfshihet jo vetëm lëvrimi i një sasive voluminoze pajisjesh në të gjithë vendndodhjet e përcaktuara për ofrimin e shërbimit (47 vendndodhje të ndryshme), por edhe instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit dhe në komponentin software që do të lëvrohet nëpërmjet kësaj kontrate, në mënyrë që shërbimi të jetë aktiv brenda afatit dy mujor të parashikuar. Nëse OE nuk ka kapacitetet e duhura gjendje në magazinë, nisur nga volumi dhe domosdoshmëria e marrjes së shërbimit objekt i kësaj kontrate, rrezikohet përmbushja e detyrimeve të saj.

Si rrjedhojë, kërkesa mbi gjendjen në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara i jep garanci autoritetit kontraktor se OE disponon kapacitetet e nevojshme teknike (pajisje e asete të tjera fizike) për të siguruar implementimin e infrastrukturës së nevojshme, në funksion të ofrimit të shërbimit brenda afatit 2 (dy) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet që të paraqesë ofertën teknike ku:

- a. Të përcaktohen marka dhe modeli për pajisjet dhe software që propozon/oferton.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë gjithashtu, katalogë ose broshurë për mallin dhe software që propozon. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produktit të propozuar. Në katalog duhet të markohet me ngjyrë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara për këto pajisje. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të software duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

**Argumenti:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40 pika 6/b (i ndryshuar), i cili përcakton se :

*Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*...b) fotografitë apo katalogët teknikë; .....*

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.

b. Operatori ekonomik duhet të faktojë teknikisht si do arrijë të përmbushë kriteret e shërbimit të suportit. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një plan monitorimi dhe zgjidhje të problematikave dhe si do mundësohet ofrimi i shërbimit brenda kohës së kërkuar. Ofertuesi duhet të paraqesë në një printscreen të faqes së internetit ku të demonstron sistemin helpdesk dhe suportit dhe një account test (username dhe password) i cili duhet të vihet në dispozicion për të menaxhuar problematikat e mundshme të përdoruesve.

**Argumenti:**Kjo kërkesë konsiston në garantimin e ofrimit të asistencës online dhe mirëmbajtjes për të gjithë problemet që do të hasen me ofrimin e shërbimit të printimit në kohë reale.

Një sistem Help Desk, automatizon një rrjedhë pune për zgjidhjen e çështjeve, centralizon informacionin dhe ofron mundësinë e njoftimit automatik me email në momentin e ndjekjes së çështjes. I gjithë ky proces jo vetëm që thjeshton komunikimin midis palëve të përfshira, por gjithashtu mundëson ndjekjen dhe gjurmimin e të gjitha problematikave të paraqitura, duke e bërë më të lehtë raportimin dhe gjurmimin e çështjeve të mbyllura në kohë reale.

Gjithashtu, disa nga avantazhet e përdorimit të sistemit “Help Desk” nga OE janë :

- Garanton prioritizimin e kërkesave të dërguara
- Lehtëson komunikimin ndërmjet palëve
- Gjurmon kohën e shpenzuar për çdo problematike të raportuar dhe zgjidhjen e saj
- Deleton kërkesat dhe problematikat e raportura sipas prioritetit
- Etj..

Për sa më sipër, menaxhimi dhe monitorimi i një sistemi “Help-desk” është më fleksibël dhe funksional duke e bërë procesin më të përshtatshëm për të gjitha palët e përfshira.

Sistemi helpdesk i shërben AK si një pikë kontakti me OE për të trajtuar të gjitha shqetësimet apo kërkesat për shërbim. Aq më tepër që konstatimi, ndërhyrja dhe zgjidhja e problemeve kërkohet të realizohet sipas termave më poshtë :

<b>Konstatimi, ndërhyrja dhe zgjidhja e problemeve</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Vendndodhja</b>	<b>Koha e Përgjigjes</b>	<b>Koha e zgjidhjes së problemit</b>
1	Në hapësirën që mbulojnë 11 (Nj.A 1..11) si dhe 3 Lagjet e reja (12,13,14)	Në vendndodhje brenda 60 minutave	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.
2	Në hapësirën që mbulojnë 13 Njësitë Administrative ish-Komuna	Në vendndodhje brenda 120 minutave	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 5 orë pas kërkesës.

Bashkia e Tiranës ka praktikën e monitorimit të shërbimeve nga operatorët ekonomik **për të siguruar transparencë të dyanshme dhe për qëllimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale**, si dhe për të matur performancën e operatorit ekonomik që do të përzgjidhet. Duke qenë se shërbimi i kërkuar është për një periudhë të parashikuar 3 (tre) vjecare dhe duke qenë se shtrihet në të gjithë Bashkinë e Tiranës në shumë institucione dhe staf personeli të shpërndarë, është e nevojshme monitorimi i shërbimit me **një sistem të qendëruar dhe të auditueshëm nga Bashkia Tiranë** si dhe nga operatori ekonomik.

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i

pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

#### **Argumentim i termave të referencës:**

I.Termit e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Blerje Shërbim të Printimit**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kontrate kërkohet të realizohet:

1. Furnizimi (vënia në dispozicion) me pajisje të reja sipas kërkesave në këtë dokument; instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimi (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
2. Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë, zëvendësimi e pjesëve konsumuese vetëm origjinale (toner/bojëra origjinal, drum origjinal, rulatë ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.
3. Garantimi i furnizimit të pandërprerë me tonera/bojëra origjinal dhe pjesëve të tjera të konsumueshme origjinale të të gjitha pajisjeve që do të përdoren, (sipas SLA të parashikuara).
4. Sigurimi i një server për të qendëruar përpunimin dhe ruajtjen e dokumentave dhe software të centralizuar për menaxhimin dhe monitorimin e shërbimit. Realizimi i instalimit dhe konfigurimit të tyre në infrastrukturën ekzistuese në institucion.

Termit e referencës të këtij shërbimi printimi , janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika

38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Blerje Shërbim të Printimit**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

*Dokumentat e tenderit*

*Termt e referencës*

**NJËSIA E PROKURIMIT**